



Bashkia e Filadelfias
Departamenti për Shëndetin e Sjelljes dhe
**Shërbimet për Aftësi të
Kufizuara Intelektuale**

Ç'prietet Procesi i koordinatorit përkrahës për punësim

Koordinatori juaj për punësim (SC):

- Do të bisedojë për punësimin tuaj gjatë çfarëdo takimesh ku përfshiheni.
- Do t'ju formojë për opsionet që keni në dispozicion.
- Do t'ju lidhë me opsionet dhe shërbimet që do t'ju ndihmojnë të arrini synimet.
- Do t'ju referojë te Drejtoria për Rehabilitim Profesional (OVR) në Pensilvani dhe do ta ndjekë procesin në emrin tuaj.
 - Sapo OVR-ja ta ketë marrë vendimin në lidhje me përmbushjen e kushteve nga ana juaj, SC juaj do të sigurohet që t'ju ofrohet një përzgjedhje me ofrues punësimi që të mund të zgjidhni atë që është më i miri për ju.
- Do të sigurojë që i gjithë dokumentacioni (si paketa e preferencës për shërbimet dhe prioritizimi i urgjencës për nevojë për shërbime) është i përditësuar.
- Do të sigurohet që plani i përkrahjes për individin (ISP) të jetë i qartë për ju dhe të pasqyrojë synimet tuaja personale.
- Do të sigurojë që synimet e punësimit të jenë renditur me qartësi nën seksionin e punësimit.
- Do të ndihmojë me opsionet e transportit, duke përfshirë por jo kufizuar në përkrahjen për familje, SEPTA, Rideshare (Uber/Lyft), dhe aplikimin te transporti i personalizuar për komunitetin (CCT).
- Do të bashkëpunojë me ofruesit e punësimit për të siguruar që po bëhet përparim.
- Do të sigurojë që të gjitha shërbimet por bashkëpunojnë për të përkrahur punësimin tuaj.
- Do t'ju referojë te një këshillues për ndihma që mund të shpjegojë ndryshimet që mund të ndodhin në sigurimet suplementare të të ardhurave (SSI) dhe sigurimet sociale për siguracionin për aftësi të kufizuara (SSDI) gjatë kohës që punoni.
- Do të mbajë lidhje me ju për punën tuaj dhe të diskutojë synimet për të ardhmen.
- Do t'ju ndihmojë të kuptoni se ç'shërbime do të keni në dispozicion kur të diplomoheni nga shkolla e mesme.

LE T'I VIHEMI PUNËS!

Për më shumë informacion, vizitoni philaonthejob.org

City of Philadelphia
 **DBHIDS**
DEPARTMENT of BEHAVIORAL HEALTH
and INTELLECTUAL disABILITY SERVICES



Njësia Shërbimet për Aftësitë e Kufizuara Intelektuale (IDS) është një ent administrativ me kontratë me Departamentin e Shërbimeve Njerëzore në Pensilvani, Drejtorinë e Programeve Zhvillimore për të administruar shërbime në qarkun e Filadelfias. IDS-ja punon me Commonwealth dhe ofruesit e shërbimeve për të ofruar përkrahje dhe shërbime cilësore që individët të kenë zgjedhje në jetët e tyre, lidhje kuptimplotë, dhe pjesëmarrje në komunitetin e tyre si qytetarë të vlerësuar.

foto: Steve Weinik